

Prishtinë, Kosovë

26 maj 2017

Drejtuar: Valdete Dakës, Kryetare e Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ)**Nga:** OJQ Germin**Tema:** Vota e Diasporës

E nderuara zonja Daka,

Më 17 maj 2017, organizata jo-qeveritare Germin, në kuadër të iniciativës *Dialogu i Strukturuar për të Drejtat e Diasporës* (<http://www.diasporaflet.org/>) ka mbajtur takim virtual (Google Hangout) me temën *Vota e Diasporës*.

Në këtë takim ishin prezent:

1. Fatmir Lekaj, politolog, Oslo, Norvegji.
2. Albesa Aliu, aktiviste rinore dhe studente, Athinë, Greqi.
3. Lulzim Veliu, kryetar i shoqatës "Identitete", Dyseldorf, Gjermani
4. Veb Kosumi, konsulent i pavarur në Ministrinë e Drejtësisë në MB, Mbretëria e Bashkuar
5. Donika Nushi, analiste e industrisë së shëndetësisë, Çikago, Shtetet e Bashkuara të Amerikës;
6. Avni Dervishi, politikan, Stokholm, Suedi

Diskutimi u moderua nga Lavdi Zymberi, hulumtuese në OJQ Germin.

Pjesëmarrja e diasporës në votim, si në zgjedhjet e përgjithshme dhe ato lokale në Kosovë, po vazhdon të jetë e ulët. Marrë parasysh afatin e shkurtër dhe procedurat burokratike, të cilat janë të papërshtatshme për diasporën, organizata Germin, e cila avokon për të drejtat e diasporës, ka filluar fushatën [#VotaeDiasporës2017](#). Në kuadër të fushatës, u organizua diskutimi virtual që kishte për qëllimin diskutimin rreth metodave për votim dhe procedurave të aplikimit për votuesit nga jashtë.

Problemet teknike, afati i shkurtër për t'u regjistruar nga jashtë si dhe mungesa e organizimit të votimit në diasporë, kanë sfiduar trefish zgjedhësit nga diaspora.

Për këtë, ne po ju dërgojmë disa nga rekomandimet e dala nga ky diskutim, të cilat mund të ju ndihmojnë në procesin e shqyrtimit të politikave për lehtësimin e votimit nga jashtë. Në këtë mënyrë që diaspora ta përmbushë të drejtën e saj të garantuar me ligj (Ligji për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligji për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës):

- Afati për regjistrim për votim jashtë vendit në zgjedhjet e parakohshme të zgjatet më shumë se 8 ditë;
- Të zhvillohen metoda të ndryshme për të lehtësuar votimin nga jashtë si: votimi online, votimi fizik, votimi në ambasada/konsullatat.

- Të krijohet databaza e të gjithë zgjedhësve nga diaspora, të regjistruar në procesin e regjistrimit nga Ministria e Diasporës, e cila do të shërbejë për t'i kontaktuar nga KQZ gjatë secilit vit zgjedhor. Kjo do të lehtësonte procesin e votimit nga jashtë pasi që pjesëtarët e diasporës nuk do të ishin nevojë të dërgojnë formularët për regjistrim për votim jashtë vendit.
- KQZ të bashkëpunojë me organizata të ndryshme të cilat merren me diasporën shqiptare në realizimin e sa më të suksesshëm të zgjedhjeve, si organizata Germin, organizata ndërkombëtare si IOM si dhe me shoqatat shqiptare në diasporë;
- KQZ të krijojë më shumë fushata informues në rrjetet sociale për ta informuar diasporën për zgjedhjet, rëndësinë e votës së tyre;
- Të krijohet një platformë online ku mërgimtarët informohen për programet politike të çdo partie.

Prandaj, duke marr parasysh që mërgata shqiptare përbën një prej grupeve më të mëdha sociale në Kosovë, lehtësimi i votimit jashtë vendit dhe impakti i tyre në politikëbërje është i rëndësishëm.

Në vazhdimësinë e aktiviteteve për ta ngritur zërin e diasporës për të drejtat e tyre politike e sociale, Germin është duke u takuar me bashkatdhetarët tanë në disa shtete të botës, për të marrë informata të hollësishme për mendimet dhe perceptimet e diasporës. Më e rëndësishmja, këto takime do të jenë të dobishme për të organizuar idetë sa i përket ngritjes së vetëdijes për të drejtat shoqërore dhe politike të diasporës. Andaj, duke marr parasysh që diaspora gjithmonë ka qenë një faktor i rëndësishëm për të mbledhur përkrahje ndërkombëtare për Kosovën si dhe duke investuar për përmirësimin e shoqërisë kosovare, Germin do të krijojë Grupin Avokues të Diasporës. Qëllimi i këtij grupi joformal është të bashkëpunojë me institucionet publike të Kosovës për të përparuar përfshirjen e diasporës në qeverinë e Kosovës.

Shpresojmë që pikat e përmendura më lartë do të hapin një diskutim më të gjerë rreth votimit të diasporës dhe lehtësimin e proceduarave aktuale për votim.

Të bashkangjitur gjeni editorialin e hartuar nga Kaltrina Kusari nga OJQ Germin me titullin [Roli i Diasporës në Zgjedhjet e Qershorit](#) dhe një shkrim se [Pse duhet diaspora të votojë në zgjedhjet e parakohshme parlamentare.](#)

Me respekt,

Liza Gashi



Drejtoreshë e Programeve në Germin